

TAKIMI I KATËRT 2025 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Takimi i fundit për vitin 2025, u mbajt më datë **22.12.2025** dhe ishte një takim shumë i rëndësishëm dhe tipik përmbajtësor, pasi lidhej me validimin e 8 standardeve, konkretisht katër standarde profesioni dhe katër standarde kualifikimesh profesionale. U rikujtua se, kualifikimet profesionale që validoheshin nga Komiteti ishin kualifikime kombëtare, të cilat ofroheshin në të gjitha shkollat në nivel kombëtar, ndaj edhe kontributi i anëtarëve gjatë takimit ishte shumë i rëndësishëm. U theksua se, nevoja për kualifikimet e hartuara ishte validuar më parë në Komitet dhe, për këtë arsye, AKAFPK kishte nisur punën për përgatitjen e dokumenteve mbi bazën e rekomandimeve të dala nga mbledhjet e mëparshme.

Validimi i standardeve të profesioneve

U bë me dije se, AKAFPK kishte përgatitur dokumentet për kualifikimet profesionale **“Multimedia”**, **“Zhvillim Website”** dhe **“Programim”**, të cilat më parë ishin ofruar si kualifikime dy vjeçare, ndërsa në vijim do të ofroheshin në formën e kualifikimeve 4-vjeçare bllok. Po ashtu, u sqarua se, **“Tregti elektronike (e-commerce)”** ishte një kualifikim i ri, i cili do të përfshihej për herë të parë në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, si një kualifikim 4-vjeçar bllok.

Sekretariati Teknik prezantoi draft-et finale të standardeve të profesioneve të përgatitura nga grupet hartuese. Sekretariati prezantoi funksionet dhe detyrat për çdo standard profesioni. Pas diskutimeve mes anëtarëve, përfaqësuesve të grupeve hartuese që ishin pjesëmarrës në takim dhe moderatorëve të grupeve hartuese, standardet e profesioneve: **“Teknik në multimedia”**, **“Zhvillues Website (i mesëm)”**, **“Programues (i mesëm)”** dhe **“Menaxher i mesëm në tregtinë elektronike (e-commerce)”**, u validuan pa ndryshime përmbajtësore.

Validimi i standardeve të kualifikimeve profesionale

Në vijim të agjendës, u prezantuan standardet përkatëse të kualifikimeve profesionale. Sekretariati prezantoi njësitë e të nxëniet dhe peshën specifike për çdo njësi të nxëniet, për çdo standard kualifikimi profesional. Për standardin e kualifikimit profesional: **“Programim”**, niveli IV në KSHK, Komiteti vendosi validimin pa ndryshime të draft-it final të hartuar.

Për standardin e kualifikimit profesional: **“Zhvillim Website”**, niveli IV në KSHK, anëtarët propozuan rritjen e peshës në % për njësitë e të nxëniet që lidheshin me Inteligjencën Artificiale dhe Sigurinë Kibernetike. Propozimet u pasqyruan në draft-in final dhe dokumenti u validua pa ndryshime të tjera.

Për standardin e kualifikimit profesional **“Multimedia”**, niveli IV në KSHK, anëtarët propozuan ndryshime të vogla në peshat e disa njësive të të nxëniet, të cilat u reflektuan në draft-in final. Standardi u validua pa ndryshime të tjera përmbajtësore.

Për standardin e kualifikimit profesional: ***“Tregti elektronike (e-commerce)”***, niveli IV në KSHK anëtarët vendosën validimin e dokumentit pa ndryshime.

Në fund u theksua se, meqë dokumentet kishin një afat vlefshmërie 4-vjeçar dhe fusha e TIK zhvillohej me ritme shumë të shpejta, ishte e nevojshme që dokumentet të ishin jetëgjata dhe lehtësisht të përshtatshme me ndryshimet e tregut të punës. U konfirmua se, gjatë gjithë procesit të hartimit, grupet hartuese kishin ndjekur parimin e përmendjes së aplikacioneve dhe programeve bazë që nuk ndryshonin, ndërsa pjesa tjetër ishte lënë e hapur për përditësime të mundshme.

Vendime të marra nga mbledhja:

- U validuan standardet e profesioneve: ***“Teknik në multimedia”***, ***“Zhvillues Website (i mesëm)”***, ***“Programues (i mesëm)”*** dhe ***“Menaxher i mesëm në tregtinë elektronike (e-commerce)”***.
- U validuan standardet e kualifikimeve profesionale: ***“Multimedia”***, niveli IV në KSHK; ***“Zhvillim Website”***, niveli IV në KSHK; ***“Programim”***, niveli IV në KSHK; dhe ***“Tregti elektronike (e-commerce)”***, niveli IV në KSHK.